



Mospranimi i kandidatit në Shkollën e Magjistraturës për shkak të dënimit si i mitur ishte në shkelje të Konventës

Çështja e [Manjani kr. Shqipërisë](#) (aplikimi nr. 32283/23) lidhet me një refuzim, në dhjetor 2020, për të pranuar ankuesin në Shkollën e Magjistraturës për formimin fillestar si prokuror, për shkak të një dënimi të marrë kur ishte i mitur, për të cilin ishte rehabilituar ligjërisht. Ankimet e tij kundër këtij vendimi ishin të pasuksesshme, pasi gjykatat e brendshme arritën në përfundimin se legjislacioni i ndalonte personat e dënuar me vendim të formës së prerë për t'u bërë prokurorë.

Në vendimin e sotshëm të **Dhomës**¹ për këtë çështje, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, vendosi, unanimisht, që kishte pasur **një shkelje të Nenit 8 (të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata theksoi që mospranimi i z. Manjani në Shkollën e Magjistraturës nuk erdhi për ndonjë mungesë të kualifikimeve të nevojshme profesionale. E vetmja arsye për refuzimin kishte qenë dënimi i tij i mëparshëm për një vepër penale të kryer kur ishte i mitur dhe pavarësisht rehabilitimit. Ndalimi absolut dhe i përhershëm i pranimit të tij, dhe si rrjedhojë, i ndjekjes së një karriere si prokuror në një fazë të hershme të zhvillimit të tij profesional, kishte pasur një ndikim të qartë dhe serioz në jetën e tij profesionale dhe private.

Gjykata vendosi që, duke u kufizuar vetëm në çështjen nëse duhej interpretuar ligji i brendshëm në një mënyrë që do të çonte në skualifikimin e personave të rehabilituar pas një dënimi për një vepër të rëndë, autoritetet kombëtare nuk kishin kryer një analizë të plotë dhe të individualizuar të rrethanave të mospranimit të z. Manjani në Shkollën e Magjistraturës dhe si rezultat, në karrierën e magjistratit. Ato kishin shpërfillur faktin që ai kishte qenë vetëm 15 vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale në fjalë, dhe e kishin trajtuar atë efektivisht si një person në moshë madhore (në kohën e kryerjes së veprës). Për më tepër, ato kishin nuk kishin vlerësuar rrethana të tjera të rëndësishme, të tilla si, natyra jo e dhunshme dhe impulsive e veprës penale.

Ndalimi për pranimin e tij në Shkollën e Magjistraturës kishte qenë jo proporcional.

Faktet kryesore

Ankuesi, Shiqiri Manjani, është një shtetas shqiptar i cili ka lindur në vitin 1991 dhe jeton në Pogradec (Shqipëri).

Në vitin 2006, në moshën 15 vjeçare, z. Manjani u dënua për vjedhje me tetë muaj burg. Gjykata e rrethit gjyqësor konstatoi se ai e kishte pranuar se e kishte kryer veprën penale, se ai kishte rrezikshmëri të ulët dhe se pasojat e veprës kishin qenë të vogla, duke marrë parasysh që prona i ishte kthyer të zotit, moshën e tij të mitur dhe nivelin e tij të edukimit. Duke marrë në konsideratë nevojën që ankuesi të vijonte shkollën, gjykata vendosi pezullimin e ekzekutimit të dënimit për tre vjet. Në bazë të një çertifikate të lëshuar në vitin 2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Ministria e

1. Në bazë të Neneve 43 dhe 44 të Konventës, ky vendim i Dhomës nuk është i formës së prerë. Gjatë kohës prej tre muajsh pas shpalljes, secila prej palëve mund t'i drejtohet Dhomës së Madhe të Gjykatës. Nëse një kërkesë e tillë paraqitet, një panel prej pesë gjyqtarësh vlerëson nëse çështja meriton një shqyrtim të mëtejshëm. Në këtë rast, Dhoma e Madhe do ta shqyrtojë çështjen dhe do të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, vendimi i Dhomës do të marrë formë të prerë në atë ditë.

Pasi vendimi merr formë të prerë, ai i përcillet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për mbikëqyrjen e mëtejshme të ekzekutimit të tij. Informacioni i mëtejshëm lidhur me procesin e ekzekutimit mund të gjendet në: www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution.

Drejtësisë), ai konsiderohej ligjërish i rehabilituar. Ai u trajnuar dhe punoi si avokat në sektorin privat, përpara se të shërbente si oficer i policisë gjyqësore prej vitit 2019 pranë një zyre prokurorie.

Në shkurt 2020 z. Manjani aplikoi për t'u pranuar pranë programit tre-vjeçar të formimit fillestar për magjistratë (profili prokuror) pranë Shkollës së Magjistraturës. Ai e deklaroi dënimin e tij. Pas një vlerësimi fillestar, ai u përfshi në listën e kandidatëve që plotësonin kriteret e pranimit për programin dhe kaloi provimin e pranimit. Si pjesë e procesit të pranimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ("KLP") kreu një kontroll të së kaluarës së ankuesit. z. Manjani sërish paraqiti informacionin lidhur me dënimin e tij në një formular vetë-deklarimi. Në dhjetor 2020, KLP vendosi që për shkak të dënimit të tij, ai nuk i plotësonte kriteret e pranimit dhe si rezultat nuk duhet të pranohet.

Ankimi i z. Manjani kundër vendimit të KLP-së u rrëzua. Në mars 2022, Gjykata e Lartë vendosi që legjislacioni i brendshëm kishte për synim ndalimin e personave të dënuar me vendim të formës së prerë që t'i bashkoheshin sistemit të drejtësisë, pavarësisht rehabilitimit, nëse vepra penale kishte qenë serioze. Vjedhja ishte një vepër penale e rëndë e kryer me dashje. Ndalimi synonte të garantonte integritetin e magjistratëve dhe ishte i lidhur me natyrën e veprës penale të kryer dhe jo aq me rrethanat se si ajo ishte kryer. Si përfundim, fakti që vepra penale ishte kryer nga personi si i mitur nuk mund të konsiderohej rrethanë lehtësuese.

Në Mars 2023, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin e paraqitur nga z. Manjani, duke e vlerësuar si të pambështetur. Garantimi i pastërtisë së figurës së funksionarëve publikë përbënte një qëllim të ligjshëm që synon mbrojtjen e pavarësisë së shtetit, rendit demokratik dhe sigurisë kombëtare. Ligji mund të kufizojë të drejtën për të ushtruar një profesion, duke vendosur disa kriteret për mbrojtjen e interesit publik. Interpretimi i ligjit nga gjykatat në rastin e z. Manjani nuk duhet të ishte arbitrar. Me përjashtim të një karriere si magjistrat, z. Manjani nuk i ishte cënuar aksesit në funksione të tjera publike apo veprimtari të lidhura me një profesion që do t'i siguronin mjetet e jetesës me punë të ligjshme.

Ankesat, procedura dhe përbërja e Gjykatës

Duke u mbështetur kryesisht në Nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), z. Manjani u ankua për vendimin për mospranimin në Shkollën e Magjistraturës për formimin fillestar si prokuror, për shkak të një dënimi si i mitur.

Ankesa u paraqit pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në 21 gusht 2023.

Vendimi u dha nga një Dhomë me shtatë gjyqtarë, me përbërje si vijon:

Ioannis Ktistakis (Greqi), *Presidenti*,
Lətif Hüseynov (Azerbaixhani),
Darian Pavli (Shqipëria),
Úna Ní Raifeartaigh (Irlanda),
Mateja Đurović (Serbia),
Canòlic Mingorance Cairat (Andorra),
Vasilka Sancin (Sllovenia),

dhe gjithashtu Milan Blaško, *Kancelar i Seksionit*

Vendimi i Gjykatës

Për sa i përket pranueshmërisë, duke pasur parasysh motivet dhe pasojat e ndalimit, Neni 8 ishte i zbatueshëm. Mospranimi i z. Manjani në Shkollën e Magjistraturës nuk vinte për ndonjë mungesë të kualifikimeve të kërkuara profesionale. Përkundrazi, ai ishte trajnuar dhe kishte punuar si avokat përpara se të bëhej oficer i policisë gjyqësore pranë një zyre të prokurorisë dhe kishte kaluar provimin e hyrjes për t'u formuar si prokuror. Arsyeja e vetme e ndalimit ishte dënimi i tij 14 vjet më parë, për

një vepër penale të kryer në moshën 15 vjeçare, për të cilën ai ishte rehabilituar, dhe e cila ishte fshirë nga gjendja e tij penale. Duke pasur parasysh moshën e tij të mitur në atë kohë, ai nuk mund të konsiderohej se kishte pasur aftësinë të parashikonte plotësisht pasojat e veprimeve të tij. Ndalimi absolut dhe i përhershëm për pranimin e tij dhe si rezultat, për ndjekjen e një karriere si prokuror në një fazë të hershme të zhvillimit të tij profesional, kishte pasur një ndikim të qartë dhe serioz në zgjedhjet e tij personale sa i përket mënyrës se si ai dëshironte të ndiqte jetën e tij profesionale dhe private, të formësonte identitetin e tij social dhe të zhvillonte marrëdhëniet me të tjerët.

Për sa i përket themelit, ndalimi përbënte një ndërhyrje në të drejtën e z. Manjani për respektimin e jetës së tij private. Ndërhyrja kishte ndjekur qëllimin e ligjshëm të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Pavarësisht se ndalimi kishte pasur një bazë ligjore në të drejtën e brendshme, Gjykata shprehu dyshime nëse legjislacioni përkatës i plotëson kriteret e “cilësisë së ligjit” në përputhje me Nenin 8. Për më tepër, Gjykata shprehu shqetësimin që ligjet e brendshme lidhur me qasjen në funksione të larta të sektorit publik nuk shprehen qartësisht në lidhje me efektet e rehabilitimit. Pavarësisht kësaj, nuk ishte e nevojshme në rrethanat e çështjes konkrete për t’u thelluar më tej në këtë pikë, pasi, edhe duke supozuar që ndërhyrja kishte qenë e ligjshme, nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, për arsyet e mëposhtme.

Prokurorët duhet të plotësojnë standarde të larta të integritetit në jetën e tyre profesionale dhe private dhe si rrjedhojë, shteti mbi këtë bazë mund të kufizojë aksesin në këtë profesion. Megjithatë, një vlerësim i individualizuar ishte i nevojshëm, veçanërisht kur bëhej fjalë për vepra penale të kryera nga një i mitur.

Arsyetimi i autoriteteve të brendshme ishte kufizuar vetëm në çështjen nëse duhej interpretuar ligji i brendshëm në një mënyrë që do të skualifikonte personat e rehabilituar, pavarësisht mungesës së dispozitave të qarta në këtë drejtim. Duke kufizuar vlerësimin e tyre në këtë mënyrë, gjykatat e brendshme nuk kishin kryer një analizë të hollësishme dhe të individualizuar të rrethanave të lidhura me mospranimin e z. Manjani në Shkollën e Magjistraturës, dhe si rezultat, në një karrierë si magjistrat. Si rrjedhojë, ato nuk kishin kryer një vlerësim të balancuar të interesave konkurruese dhe të justifikonin se përse ndalimi i pranimit të ankuesit në këtë institucion ishte proporcional dhe përputhej me konceptin e respektimit të jetës private.

Fakti që z. Manjani kishte qenë 15 vjeç në kohën e veprës penale ishte vlerësuar si pak i rëndësishëm. E njëjta gjë vlente për kohën e kaluar që nga momenti i kryerjes së veprës penale, sjelljes së tij gjatë kësaj kohe dhe gravitetit të veprës penale konkrete. Gjykatat e brendshme nuk kishin marrë parasysh gjetjet e gjykatës që kishte dhënë dënimin dhe nuk e kishin vlerësuar karakterin e z. Manjani në kohën e aplikimit të tij pranë Shkollës së Magjistraturës, ose nëse kishte pasur ndonjë arsye për të besuar që, nëse do të pranohej, ai do të sillte në një mënyrë që do të cënonte imazhin e prokurorit.

Kur motivi për ndërhyrjen në jetën private të një personi është i lidhur me një vepër penale të kryer në moshë të mitur, zbatohet detyrimi për të marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës. Ky detyrim dhe detyrimi për sistemin e drejtësisë për të mitur për të synuar riintegrimin janë përfshirë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Këto parime janë gjithashtu të përfshira në Kodin Shqiptar të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Duke mos e marrë në konsideratë moshën e z. Manjani dhe duke trajtuar njësoj autorët e mitur dhe të rritur të veprave penale, autoritetet shqiptare dështuan në vlerësimin e duhur të këtyre elementëve. Për më tepër, një sërë rrethanash të rëndësishme nuk u morën në konsideratë mjaftueshëm, duke përfshirë dhe natyrën jo të dhunshme dhe impulsive të veprës penale, e cila mund të shihet si një veprim tipik i kriminalitetit në moshë të re; kohën e kaluar nga momenti i kryerjes së veprës; sjelljen e tij në përputhje me ligjin gjatë kohës pas dënimit, gjatë së cilës ai ishte trajnuar dhe kishte punuar si avokat përpara se të bëhej oficer i policisë gjyqësore në një zyrë prokurorie; dhe karakterin e tij në atë kohë. Ndalimi ishte vendosur në një fazë të hershme të jetës profesionale të ankuesit dhe si rezultat kishte pasur një ndikim të rëndësishëm për shkak të kohëzgjatjes së tij.

